



Maj 2020

# KËRKESAT LIGJORE PËR RAPORTIM FINANCIAR PËR MIKRO-NDËRMARRJE & NVM

SCAAK



**PUBLIKUES**

© Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Departamenti për Pajtueshmëri me Standardet

Sylejman Vokshi nr.14 Prishtinë, 10.000 Kosovë

Tel: 038 249 043 dhe 038 249 045

**Faqja e internetit:**

[www.scaak.org](http://www.scaak.org)

**Adresa elektronike:**

[info@scaak.org](mailto:info@scaak.org)

## Përmbajtja

Hyrje .....	1
1. Klasifikimi i shoqërive tregtare .....	1
2. Përgatitja e Pasqyrave Financiare Vjetore .....	3
3. Nënshkrimi i Pasqyrave Financiare .....	5
4. Raportime shtesë .....	6
5. Afati për dorëzimin e dokumentacionit në KKRF .....	7
6. Regjistrat kontabël dhe ruajta e dokumenteve .....	8
Aneks 1 .....	10
Aneks 2 .....	11
Aneks 3 .....	13
Aneks 4 .....	16
Aneks 5 .....	22

## Hyrje

Sistemi i kontabilitetit dhe i raportimit financiar të shoqërive tregtare në Kosovë rregullohet me *Ligjin Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim*, i cili ka hyrë në fuqi që nga data 1 janar 2020 (duke shfuqizuar ligjin paraprak nr. 04/L-014).

Kërkesat ligjore të cilat rrjedhin nga ky ligj janë të obligueshme për të gjitha shoqëritë tregtare të regjistruara dhe të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës.

Shoqëri tregtare konsiderohet çfarëdo lloji i shoqërisë tregtare, çiftë biznes individual (B.I) , ortakëri (O), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.) apo shoqëri aksionare (Sh.a.), e themeluar në Kosovë sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.

Bazuar në kërkesat e ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, shoqëritë tregtare janë të obliguara të përgatisin pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme. Me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme duhet të zbatohen Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF), SNRF-të për NVM dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF).

Periodha raportuese për të gjitha shoqëritë tregtare në Kosovë është 12 muaj, 1 Janar 20xx– 31 Dhjetor 20xx.

### 1. Klasifikimi i shoqërive tregtare

Sipas legjislacionit në fuqi (*Ligji Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Neni 5*) shoqëritë tregtare klasifikohen si:

- Mikro ndërmarrje,
- Ndërmarrje të vogla,
- Ndërmarrje të mesme dhe
- Ndërmarrje të mëdha.

Për t' u klasifikuar në njëri nga këto kategori shoqëritë tregtare duhet të krahasojnë bilancin e pasqyrës së pozitës financiare, qarkullimin vjetor neto dhe numrin mestarë të punonjësve gjatë vitit.

Shoqëritë tregtarë duhet të plotësojnë dy nga tre kriteret e më poshtme për të përcaktuar cilës kategori të shoqërive tregtare ju përkasin (pa marrë parasysh formën e organizimit B.I, O, Sh.p.k. apo Sh.a) dhe cilat kërkesa ligjore për raportim financiar duhet të plotësojnë.

**Tabela 1:** Klasifikimi i ndërmarrjeve të Kosovës sipas kriterëve të përcaktuara me ligj

	<b>Mikro ndërmarrje</b>	<b>Ndërmarrje e vogël</b>	<b>Ndërmarrje e mesme</b>	<b>Ndërmarrje e madhe</b>
<b>Totali i qarkullimit vjetor neto</b>	€0 – €700,000	Mbi €700,000 deri €8,000,000	Mbi €8,000,000 deri €40,000,000	Mbi €40,000,000
<b>Totali i pasurisë më 31.12.20XX</b>	€0 – €350,000	Mbi €350,000 deri €4,000,000	Mbi €4,000,000 deri €20,000,000	Mbi €20,000,000
<b>Numri mestar i të punësuarve gjatë vitit</b>	0 – 10	Mbi 10 deri 50	Mbi 50 deri 250	Mbi 250

Mikro ndërmarrjet nën-klasifikohen në tri klasa të ndryshme bazuar në *Udhëzimin Administrativ Nr.01/2020 për Raportimet Financiare Vjetore të Mikro Ndërmarrjeve, Neni 5*. Qëllimi i këtij nën-klasifikimi është të përcaktoj përmbajtjen dhe dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore për këtë kategori të ndërmarrjeve.

Mikro Ndërmarrjet nën-klasifikohen në këto klasa:

**Tabela 1a:** Nën klasifikimi i mikro ndërmarrjeve

<b>MIKRO</b>	<b>Klasa 1</b>	<b>Klasa 2</b>	<b>Klasa 3</b>
<b>Totali i qarkullimit vjetor neto</b>	Deri €50,000	Mbi €50,000 deri €300,000	Mbi €300,000

## 2. Përgatitja e Pasqyrave Financiare Vjetore

Pasi që shoqëria tregtare të jetë klasifikuar në njëren nga kategoritë e lartë cekura duhet të përgatisë pasqyrat financiare vjetore në bazë të kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Kërkesat për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore për Mikro Ndërmarrje përcaktohen në *Ligji Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim; Neni 9, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.01/2020 për Raportimet Financiare Vjetore të Mikro Ndërmarrjeve Neni 6.*

Nëse një ndërmarrje klasifikohet fillimisht si mikro-ndërmarrje sipas kriterëve të dhëna në tabelën 1 (shih më lartë), dhe nëse **Mikro Ndërmarrja** i takon **klasës 1**, d.m.th ka qarkullim deri në €50,000, atëherë obligohet të përgatisë vetëm pasqyrën e të ardhurave për periudhën raportuese. Baza për përgatitjen e pasqyrës së të ardhurave është *parimi i parasë së gatshme* ose *parimi akrual* cilindo që e për zgjedh ndërmarrja. Për më shumë informata lidhur me formën e përgatitjes së pasqyrës financiare referohuni në *Aneks 2 (faqe 11)* i cili paraqet një model ilustrues të pasqyrës së të ardhurave.

Nëse një ndërmarrje klasifikohet fillimisht si mikro-ndërmarrje sipas kriterëve të dhëna në tabelën 1 (shih më lartë), dhe nëse **Mikro Ndërmarrja** i takon **klasës 2**, d.m.th ka qarkullim më të madhë se €50,000 por jo më shumë se €300,000, obligohet të përgatisë pasqyrën e pozitës financiare dhe pasqyrën e të ardhurave për periudhën raportuese. Baza për përgatitjen e pasqyrave financiare është *parimi akrual i kontabilitetit*. Për më shumë informata lidhur me formën e përgatitjes së pasqyrave financiare referohuni në *Aneks 3 (faqe 13)* i cili paraqet një model ilustrues të pasqyrave financiare.

Nëse një ndërmarrje klasifikohet fillimisht si mikro-ndërmarrje sipas kriterëve të dhëna në tabelën 1 (shih më lartë), dhe nëse **Mikro Ndërmarrja** i takon **klasës 3**, d.m.th ka qarkullim mbi €300,000, obligohet të përgatisë pasqyrat financiare vjetore të plota. Pasqyrat financiare vjetore duhet të përgatiten në pajtueshmëri me kërkesat që rrjedhin nga *Standardi Ndërkombëtar për Raportim Financiar për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM)*. Për më shumë informata lidhur me formën e përgatitjes së pasqyrave financiare referohuni në *Aneks 4 (faqe 16)* i cili paraqet një model ilustrues të pasqyrave financiare sipas SNRF për NVM.

Kërkesat për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore për Ndërmarrje të Vogla, të Mesme dhe të Mëdha përcaktohen në *Ligjin Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim; Neni 8.*

Nëse shoqëria tregtare klasifikohet si **Ndërmarrje e Vogël**, plotëson dy nga tre kriteret e ndërmarrjeve të vogla (shih tabela 1), sipas legjislacionit në fuqi obligohet të përgatisë pasqyrat financiare vjetore të plota. Pasqyrat financiare vjetore duhet të përgatiten në pajtueshmëri me kërkesat që rrjedhin nga *Standardi Ndërkombëtar për Raportim Financiare për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM)*. Për më shumë informata lidhur me formën e përgatitjes së pasqyrave financiare referohuni në *Aneks 4 (faqe 16)* i cili paraqet një model ilustrues të pasqyrave financiare sipas SNRF për NVM.

Nëse shoqëria tregtare klasifikohet si **Ndërmarrje e Mesme**, plotëson dy nga tre kriteret e ndërmarrjeve të mesme (shih tabela 1), sipas legjislacionit në fuqi obligohet të përgatisë pasqyrat financiare vjetore të plota. Pasqyrat financiare vjetore duhet të përgatiten në pajtueshmëri me kërkesat që rrjedhin nga *Standardi Ndërkombëtar për Raportim Financiare për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM)*. Për më shumë informata lidhur me formën e përgatitjes së pasqyrave financiare referohuni në *Aneks 4 (faqe 16)* i cili paraqet një model ilustrues të pasqyrave financiare sipas SNRF për NVM.

**Tabela 2:** Kërkesa për raportim financiar sipas klasifikimit të shoqërisë tregtare

Ndërmarrja / Raportimi	Pasqyrat e Pozitës Financiare	Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	Pasqyra e ndryshimeve në Ekuitet	Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë	Shpalosjet dhe shënimet shpjeguese
Mikro Ndërmarrje <b>Klasa I</b>	-	√	-	-	-
Mikro Ndërmarrje <b>Klasa II</b>	√	√	-	-	-
Mikro Ndërmarrje <b>Klasa III</b>	√	√	√	√	√
Ndërmarrje e <b>Vogël</b>	√	√	√	√	√
Ndërmarrje e <b>Mesme</b>	√	√	√	√	√

**Tabela 2a:** Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare bazuar në klasifikimin e shoqërisë tregtare

	Mikro Ndërmarrje <b>Klasa I</b>	Mikro Ndërmarrje <b>Klasa II</b>	Mikro Ndërmarrje <b>Klasa III</b>	Ndërmarrje e <b>Vogël</b>	Ndërmarrje e <b>Mesme</b>
Baza e përgatitjes së pasqyrave	Parimi i parasë së gatshme ose Parimi akrual	Parimi Akrual	SNRF për NVM	SNRF për NVM	SNRF për NVM

### 3. Nënshkrimi i Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare vjetore të **Mikro Ndërmarrjeve** të cilat i takojnë **Klasës 1** kërkohet të nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv ose Pronari, kurse për **Klasën 2** duhet të nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtori Financiar ose Kontabilisti i Çertifikuar. Ndërsa, Pasqyrat financiare vjetore të Mikro Ndërmarrjeve të **Klasës 3** kërkohet të nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutivë dhe Drejtori Financiar (nëse Drejtori Financiar nuk është Kontabilist i certifikuar, atëherë pasqyrat financiare *obligohet të nënshkruhen edhe nga një Kontabilist i Çertifikuar - UA 01/2020 për Raportimet Financiare Vjetore të Mikro Ndërmarrjeve, Neni 7*).

Pasqyrat financiare vjetore të **Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme** duhet të nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutivë dhe Drejtori Financiar (nëse Drejtori Financiar nuk është Kontabilist i certifikuar, atëherë pasqyrat financiare obligohet të nënshkruhen edhe nga një Kontabilist i Çertifikuar - *Ligji Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim; Neni 8*).



#### 4. Raportime shtesë

Përveç përgatitjes së pasqyrave financiare, nga shoqëritë tregtare të cilat operojnë në territorin e Kosovës, kërkohet të shpalosin edhe disa informacione shtesë varësisht nga klasifikimi i shoqërisë tregtare.

Bazuar në kërkesat e *Udhëzimit Administrative Nr. 01/2020 për Raportim financiar të mikro ndërmarrjeve* e cila rregullon raportimin financiar të mikro-ndërmarrjeve kërkon nga **mikro ndërmarrjet e klasës I dhe II** të shpalosin informata lidhur me:

- i. Numrin mesatar të punësuarve gjatë periudhës raportuese;
- ii. Gjithsej pasuritë dhe gjithsej detyrimet në datën e fundit të periudhës raportuese; dhe
- iii. Bazën apo Parimin mbi të cilin janë përgatitur pasqyrat financiare

(UA 01/2020; Neni 6, pika 4)

Kërkesat për raportim shtesë për *Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme* rregullohen me *Ligjin Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim*. Sipas kërkesave të këtij ligji shoqëritë tregtare të cilat klasifikohen qoftë si ndërmarrje të vogla apo ndërmarrje të mesme dhe kanë **qarkullim vjetor neto më të vogël apo të barabartë me €4 milion** duhet të bashkëngjisin pasqyrave financiare **Raportin e Rishikimit** nga Auditori i Licencuar nga KKRF. Kurse NVM-të me **qarkullim vjetor neto mbi €4 milion** duhet të bashkëngjisin pasqyrave financiare **Raportin e Auditimit** nga firma e auditimit e licencuar nga KKRF. (*Ligji nr. 06/l-032, Neni 8 pika 1.1 dhe 1.3*)

Gjithashtu nga **mikro-ndërmarrjet e klasës II dhe III, si dhe NVM-të me qarkullim vjetor mbi €4 milion** kërkohet që të bashkëngjitet edhe *'Deklarata e Pajtueshmërisë'* e nënshkruar nga drejtori ekzekutiv apo pronari dhe zyrtari kryesore financiar apo personi përgjegjës për financa ku *deklarohet që pasqyrat financiare paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve dhe rrjedhës së parasë të ndërmarrjes*. (*Ligji nr. 06/l-032, Neni 8 pika 10; UA 01/2020; Neni 6, pika 2.1 dhe 3.1*) Për më shumë informata lidhur me formën e përgatitjes së deklaratës së pajtueshmërisë referohuni në *Aneks 5 (faqe 22)* i cili paraqet një model ilustrues të deklaratës së pajtueshmërisë.

**Tabela 3:** Raportimet shtesë sipas kategorive të ndërmarrjeve të kërkuar me ligj

Kategoria	Shpalosjet	Deklarata e Pajtueshmërisë	Raporti i Rishikimit	Raporti i Auditimit
Mikro-ndërmarrje Klasa I	√	-	-	-
Mikro-ndërmarrje Klasa II	√	√	-	-
Mikro-ndërmarrje Klasa III	-	√	-	-
NVM me qarkullim vjetor neto ≤ €4M	-	-	√	-
NVM me qarkullim vjetor neto > €4M	-	√	-	√

## 5. Afati për dorëzimin e dokumentacionit në KKRF

Të gjitha pasqyrat financiare dhe raportimet shtese kërkohet të dorëzohen në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) **deri më 30 prill** të vitit pasues, ndërsa pasqyrat financiare të konsoliduara (për grupet) kërkohet të dorëzohen në KKRF **deri më 30 qershor** të vitit pasues.

Shoqëritë tregtare të cila gjatë vitit afarist nuk ka pasur aktivitet afarist dhe nuk ka regjistruar

asnjë të dhënë mbi pasuritë dhe detyrimet në librat kontabël, dorëzojnë në KKRF *deklaratën për pasivitet të vitit paraprak* afarist **deri më 31 mars** të vitit në vijim.

Dokumentet duhet të dorëzohen në KKRF në kopje fizike dhe elektronike.

Vetëm pasqyrat financiare të shoqërive tregtare të cilat auditohen publikohen në web-faqen e KKRF-së. (*Ligji Nr. 06/L-032, Neni 18*)

Në rast të mos dërgimit të dokumentacionit të kërkuar apo dërgimit me vonesë në KKRF, me ligj parashihen të drejtat për shqiptimin e masave ndëshkimore në varësi të klasifikimit të ndërmarrjes. (*Ligji Nr. 06/L-032, Neni 36*)

## 6. Regjistrat kontabël dhe ruajta e dokumenteve

Legjislacioni në Kosovë obligon shoqëritë tregtare të mbajnë regjistra kontabël dhe specifikon kushtet nën të cilat duhet të mbahen dhe ruhen librat financiar/kontabël.

Sipas legjislacionit aktual në fuqi, librat kryesor kontabël duhet të mbyllen deri në fund të vitit afarist. Viti fiskal në Kosovë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Regjistrat kontabël kërkohet të mbahen në gjuhën shqipe dhe njësia monetare e përdorur është Euro.

Regjistrat kontabël përfshijnë, regjistra të hyrjeve fillestare kontabël dhe regjistra mbështetës, siç janë kontrollet dhe regjistrat e transfereve të fondeve elektronike; faturave; kontratave; librave kryesor dhe ato dytësor, shënimeve në ditar dhe rregullimeve tjera në pasqyrat financiare të cilat nuk janë reflektuar tek hyrjet në ditar, dhe regjistrat si fletë pune që mbështesin alokimet e kostos, llogaritjet, barazimet dhe shpalojet. Regjistrat kontabël ruhen në sistemin e regjistrimit të dyfishtë kontabël.

Librat e llogarisë përfshijnë regjistrat apo librat, ku regjistrohen të gjitha transaksionet e shoqërisë tregtare.

Librat kontabël përfshijnë regjistra dhe ditarë. **Ditari** është libër kontabël në të cilin regjistrohen transaksionet në atë mënyrë se si kanë ndodhur.

**Libri kryesor** është regjistër kronologjik kontabël i cili përdoret për të mbajtur gjurmët e transaksioneve financiare. Transaksionet kategorizohen dhe përmbledhen në llogaritë e Librit kryesor. Llogaria është regjistër i veçantë për secilin lloj të pasurisë, detyrimit, kapitalit, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe zërave jashtë bilancit të gjendjes. Llogaritë e librit përfshijnë të gjitha llogaritë e planit kontabël të njësisë ekonomike. (Ligji Nr. 06/L-032, Neni 11)

**Ditari, libri kryesor dhe librat mbështetëse** kërkohet të ruhen për të paktën **dhjetë (10)** vjet dhe kjo periudhë fillon nga dita e fundit e vitit financiar.

Listat e pagave duhet të ruhet **në afat të pacaktuar**.

Dokumentet kontabël në bazë të të cilave janë mbajtur llogaritë ruhen për të paktën pesë (5) vjet.

Blloqet e shitjes apo format ndihmëse dhe dokumentacionet e ngjashme, dokumentet që lidhen me veprimtarinë e pagesave kërkohet të ruhen për të paktën tre (3) vjet. (Ligji Nr. 06/L-032, Neni 20)



Sipas legjislacionit në fuqi kërkohet nga shoqëritë tregtare që të paktën një (1) herë në vit, të verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. *(Ligji Nr. 06/L-032, Neni 12).*

## ANEKS 1:

Lista e plotë e Ligjeve dhe UA-ve të prezantuar në këtë tekst<sup>1</sup>

- Ligji Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2020 për Raportim financiar të mikro ndërmarrjeve
- Udhëzimi Administrativ Nr .07/2019 për Strukturën, Përmbajtjen dhe dorëzimin e raportimeve financiare vjetore

---

<sup>1</sup> Të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative të publikuara nga KKRF gjenden të publikuara në web faqen e ShKÇAK në këtë link: <https://www.scaak.org/Al/ligjet-dhe-udhezimet-administrative-te-kkrf-se/>

## ANEKS 2:

Model ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare për Klasën I të Mikro-ndërmarrjeve

"ABC" SH.P.K.

Pasqyra e të ardhurave  
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 20xy

	20xy €	20xx €
Të hyrat	Xxxx	Xxxx
Kostoja e shitjes	(xxxx)	(xxxx)
<b>Fitimi / (humbja) bruto</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>
Të ardhurat tjera	xxxx	Xxxx
Shpenzimet e shitjes	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e pagave bruto	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e qirasë	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e marketingut	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e tjera	(xxxx)	(xxxx)
<b>Fitimi / (humbja) operativ</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>
Shpenzimet financiare	(xxxx)	(xxxx)
Të ardhurat financiare	xxxx	Xxxx
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	(xxxx)	(xxxx)
<b>Fitimi / (humbja) i/e vitit</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>

Drejtori i ekzekutiv apo pronari

\_\_\_\_\_

## Shpalosjet

1. Numrin mesatar i të punësuarve gjatë periudhës raportuese 20XX ka qenë \_\_\_\_\_.

2. Totali i pasurisë (aseteve) më 31.12.20XX ishte \_\_\_\_\_. Totali i detyrimeve më 31.12.20XX ishte \_\_\_\_\_.

3. Baza apo parimin mbi të cilin janë ndërtuar pasqyrat financiare është e \_\_\_\_\_.

*Drejtori i ekzekutiv apo pronari*

\_\_\_\_\_

### ANEKS 3:

Model ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare për Klasën II të Mikro-ndërmarrjeve

**"ABC" SH.P.K.**  
Pasqyra e pozitës financiare  
më 31 dhjetor 20xy

	20xy	20xx
	€	€
<b>PASURITË</b>		
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>		
Paraja në arkë dhe në bankë	Xxxx	xxxx
Investimet financiare afatshkurtra	Xxxx	xxxx
Llogaritë e arkëtueshme	Xxxx	xxxx
Mallërat (stoqet)	Xxxx	xxxx
Pasuritë e tjera afatshkurtra	Xxxx	xxxx
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>	<u>Xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<b>Pasuritë afatgjata</b>		
Prona, pajisjet dhe impiantet	Xxxx	xxxx
Pasuritë e paprekshme	Xxxx	xxxx
Pasuritë e tjera afatgjata	Xxxx	xxxx
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>	<u>Xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<b>Gjithsej pasuritë</b>	<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>		
<b>DETYRIMET</b>		
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		
Llogaritë e pagueshme	xxxx	xxxx
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurter	xxxx	xxxx
Tatimin në fitim i pagueshëm	xxxx	xxxx
Detyrimet e tjera afatshkurtra	xxxx	xxxx
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>	<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<b>Detyrimet afatgjata</b>		
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	xxxx	xxxx
Detyrimet e tjera afatgjata	xxxx	xxxx
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>	<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<b>Gjithsej detyrimet</b>	<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<b>EKUITETI</b>		
Kapitali aksionar apo i pronarit	xxxx	xxxx
Fitimet e mbajtura	xxxx	xxxx
Fitimi i vitit	xxxx	xxxx
Rezervat e tjera	xxxx	xxxx
<b>Gjithsej ekuiteti</b>	<u>Xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>	<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<i>Drejtori i Ekzekutiv</i>	<i>Drejtori financiar/kontabilisti i certifikuar</i>	



"ABC" SH.P.K.

Pasqyra e të ardhurave  
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 20xy

	20xy €	20xx €
Të hyrat	Xxxx	Xxxx
Kostoja e shitjes	(xxxx)	(xxxx)
<b>Fitimi / (humbja) bruto</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>
Të ardhurat tjera	xxxx	Xxxx
Shpenzimet e shitjes	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e pagave bruto	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e zhvlerësimit	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e qirasë	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e marketingut	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e tjera	(xxxx)	(xxxx)
<b>Fitimi / (humbja) operativ</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>
Shpenzimet financiare	(xxxx)	(xxxx)
Të ardhurat financiare	xxxx	Xxxx
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	(xxxx)	(xxxx)
<b>Fitimi / (humbja) i/e vitit</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>	<b>Xxxx / (xxxx)</b>

## Shpalosjet

1. Nunrin mesatar i të punësuarve gjatë periudhës raportuese 20XX ka qenë\_\_\_\_\_.

2. Totali i pasurisë (aseteve) më 31.12.20XX ishte\_\_\_\_\_. Totali i detyrimeve më 31.12.20XX ishte\_\_\_\_\_.

3. Baza apo parimin mbi të cilin janë ndërtuar pasqyrat financiare është\_\_\_\_\_.

*Drejtori i Ekzekutiv*

\_\_\_\_\_

*Drejtori financiar/kontabilisti i  
certifikuar*

\_\_\_\_\_

## ANEKS 4:

Model ilustrues i prezantimit të pasqyrave financiare individuale në pajtueshmëri me SNRF për NVM, i vlefshëm për Klasën III të Mikro-ndërmarrjeve dhe NVM.

**"ABC" SH.P.K.**

**Pasqyra e pozitës financiare**  
**më 31 dhjetor 20xy**

	Shënimi	20xy €	20xx €
<b>PASURITË</b>			
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	x	Xxxx	xxxx
Investimet financiare afatshkurtra	X	Xxxx	xxxx
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	X	Xxxx	xxxx
Stoqet	X	Xxxx	xxxx
Pasuritë e tjera afatshkurtra	X	Xxxx	xxxx
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<u>Xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<b>Pasuritë afatgjata</b>			
Investimet në pjesëmarrje	X	Xxxx	xxxx
Investimet në filiale	X	Xxxx	xxxx
Investimet financiare afatgjata	X	Xxxx	xxxx
Prona, pajisjet dhe impiantet	X	Xxxx	xxxx
Prona investuese	X	Xxxx	xxxx
Investimet në vijim	X	Xxxx	xxxx
Pasuritë e paprekshme	X	Xxxx	xxxx
Pasuritë e shtyra tatimore	X	Xxxx	xxxx
Pasuritë e tjera afatgjata	X	Xxxx	xxxx
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<u>Xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Mbitërheqja bankare		xxxx	xxxx
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	X	xxxx	xxxx
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	X	xxxx	xxxx
Interesi i pagueshëm	X	xxxx	xxxx
Tatimin në fitim i pagueshëm	X	xxxx	xxxx
Provizionet afatshkurtra	X	xxxx	xxxx
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkurtër	X	xxxx	xxxx
Detyrimet e tjera afatshkurtra	X	xxxx	xxxx
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<u>xxxx</u>	<u>xxxx</u>

<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	X	XXXX	XXXX
Provizionet afatgjata		XXXX	XXXX
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatgjatë	X	XXXX	XXXX
Detyrimet e shtyra tatimore	X	XXXX	XXXX
Detyrimet e tjera afatgjata	X	XXXX	XXXX
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<u>XXXX</u>	<u>XXXX</u>
		XXXX	XXXX
<b>Gjithsej detyrimet</b>			
<b>EKUITETI</b>			
Kapitali aksionar	X	XXXX	XXXX
Fitimet e mbajtura	X	XXXX	XXXX
Rezervat e tjera	X	XXXX	XXXX
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<u>XXXX</u>	<u>XXXX</u>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<u>XXXX</u>	<u>XXXX</u>

*Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv*

\_\_\_\_\_

*Drejtori financiar/Kontabilisti i*

*Certifikuar*

\_\_\_\_\_

"ABC" SH.P.K.

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse  
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 20xy

	Shënimi	20xy €	20xx €
Të hyrat	X	Xxxx	Xxxx
Kostoja e shitjes	X	(xxxx)	(xxxx)
<b>Fitimi / (humbja) bruto</b>		<u>Xxxx / (xxxx)</u>	<u>Xxxx / (xxxx)</u>
Të ardhurat tjera	X	xxxx	Xxxx
Shpenzimet e shpërndarjes	X	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet administrative	X	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet e tjera	X	(xxxx)	(xxxx)
<b>Fitimi / (humbja) operativ</b>		<u>Xxxx / (xxxx)</u>	<u>Xxxx / (xxxx)</u>
Shpenzimet financiare	X	(xxxx)	(xxxx)
Të ardhurat financiare	X	xxxx	Xxxx
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<u>Xxxx / (xxxx)</u>	<u>Xxxx / (xxxx)</u>
Shpenzimet e tatimit në fitim	X	<u>(xxxx)</u>	<u>(xxxx)</u>
<b>Fitimi / (humbja) i/e vitit</b>		<u>Xxxx / (xxxx)</u>	<u>Xxxx / (xxxx)</u>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</b>			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi	X	<u>Xxxx / (xxxx)</u>	<u>Xxxx / (xxxx)</u>
<b>Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit</b>		<u>Xxxx / (xxxx)</u>	<u>Xxxx / (xxxx)</u>
<b>Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit</b>		<u>Xxxx / (xxxx)</u>	<u>Xxxx / (xxxx)</u>

"ABC" SH.P.K.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet  
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 20xx

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat e tjera	Gjithsej
	€	€	€	€
Gjendja më 1 janar 20xx	xxxx	xxxx / (xxxx)	xxxx	xxxx
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	xxxx / (xxxx)	-	xxxx / (xxxx)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	xxxx / (xxxx)	-	xxxx / (xxxx)
Dividendat	-	(xxxx)	-	(xxxx)
Deponimet e kapitalit shtesë	xxxx	-	-	xxxx
Ndarja e rezervave	-	(xxxx)	xxxx	-
Gjendja më 31 dhjetor 20xx	xxxx	xxxx / (xxxx)	xxxx	xxxx
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	xxxx / (xxxx)	-	xxxx / (xxxx)
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	xxxx / (xxxx)	xxxx / (xxxx)
Dividendat	-	(xxxx)	-	(xxxx)
Deponimet e kapitalit shtesë	xxxx	-	-	xxxx
Ndarja e rezervave	-	(xxxx)	xxxx	-
Gjendja më 31 dhjetor 20xy	xxxx	xxxx / (xxxx)	xxxx	xxxx

"ABC" SH.P.K.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë  
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 20xy

Shënimi	20xy €	20xx €
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	Xxxx / (xxxx)	Xxxx / (xxxx)
<i>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</i>		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	Xxxx	Xxxx
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	Xxxx	Xxxx
Amortizimi i pasurive të paprekshme	Xxxx	Xxxx
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme	Xxxx	Xxxx
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese	Xxxx	Xxxx
Të ardhurat financiare	(xxxx)	(xxxx)
Shpenzimet financiare	Xxxx	Xxxx
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	(Xxxx)/xxxx	(Xxxx)/xxxx
Shpenzimet e tatimit në fitim	Xxxx	Xxxx
	<hr/>	<hr/>
	Xxxx	Xxxx
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(xxxx) / xxxx	(xxxx) / xxxx
(Rritja) / zvogëlimi në stocqe	(xxxx) / xxxx	(xxxx) / xxxx
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	(xxxx) / xxxx	(xxxx) / xxxx
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	xxxx / (xxxx)	xxxx / (xxxx)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	xxxx / (xxxx)	xxxx / (xxxx)
	<hr/>	<hr/>
	xxxx	Xxxx
Tatimi në fitim i paguar	(xxxx)	(xxxx)
Interesi i paguar	(xxxx)	(xxxx)
	<hr/>	<hr/>
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>xxxx</b>	<b>Xxxx</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(xxxx)	(xxxx)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	xxxx	Xxxx
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme	(xxxx)	(xxxx)
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme	xxxx	xxxx
Interesi i arkëtuar	xxxx	xxxx
Dividendat e arkëtuara	xxxx	xxxx
	<hr/>	<hr/>
	(xxxx)	
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>		<b>(xxxx)</b>

<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Deponimet e kapitalit shtesë	Xxxx	xxxx
Dividendat e paguara	(xxxx)	(xxxx)
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	xxxx	xxxx
Ripagimi i kredive dhe huave	(xxxx)	(xxxx)
Pagesat e lizingut financiar	(xxxx)	(xxxx)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<u>(xxxx)</u>	<u>(xxxx)</u>
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>	xxxx / (xxxx)	xxxx / (xxxx)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	xxxx	Xxxx
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	x <u>xxxx</u>	<u>Xxxx</u>





## ANEKS 5:

Shembull i një Deklarate të Pajtueshmërisë

LOGO DHE TË DHËNAT E SHOQERISË TREGTARE

### Deklaratë e Pajtueshmërisë

-Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31.12.20XX-

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 20XX paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e *Ligjit 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim*.

Drejtori Ekzekutiv

---

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Drejtori Financiar

---

(emri, mbiemri, nënshkrimi)

(Vendi, Data)